



**VENDIM**

*Nr. 111 Datë 27.12.2010*

**PËR  
FILLIMIN E PROÇEDURAVE MBI  
RISHIKIMIN E KONTRATËS SË FURNIZIMIT ME ENERGJI  
ELEKTRIKE TË KLIENTËVE TARIFORË**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 44 pika 3, të Ligjit nr.9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 121 dhe 128, të Ligjit nr.8485, date 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative“, nenit 26 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin nr. 21, datë 18.03.2009, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Bordi i Komisionereve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 27.12.2010, mbasi shqyrtoi draftin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike të saj dhe relacionin përkatës,

**Vendosi:**

1. Fillimin e procedurave për rishikimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve tariforë.
2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë Cez Shpërndarje sh.a për vendimin e Bordit të Komisionerëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.  
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.